



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 71-të të mbajtur më 30.06.2022 ka miratuar sa vijon

### VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-2510/1 të datës 22.07.2020, është formuar sipas denoncimit të dorëzuar kundër më shumë personave, ndër të cilët edhe persona zyrtarë, NDËRPRITET.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme për arsye të të dhënave të pamjaftueshme dhe informata për rastin e denoncuar, ndërsa parashtruesi nuk u përgjigj ndaj kërkesës së KSHPK-së për plotësimin e kërkesës.

Lënda me numër 12-2510/1 të datës 22.07.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Më 22.07.2020, u dorëzua denoncim kundër disa personave, ndër të cilët edhe persona zyrtarë dhe u formua lënda me numër 12-2510/1 të datës 22.07.2020.

Në denoncim tregohet se një përmbarues nga ----- së bashku me një ish-kryetar të gjykatës themelore, pronarë të një kompanie ndërtimore, një ish-udhëheqëse e kadastrës, si dhe persona fizikë, të gjithë së bashku pa në dijeni të parashtruesit kanë miratuar aktgjykim sikur parashtruesit t'i kenë borxh "tiko ose skuter" dhe i kanë marrë një banesë me sipërfaqe prej 37 m<sup>2</sup>. Parashtruesi thekson se për këtë e kanë marrë vesh rastësisht, pas së cilës kanë bërë kundërshtim dhe u është kthyer pronësia dhe më pas përmbaruesi ua ka hequr pronësinë për herë të dytë,

pavarësisht aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative. Në denoncim, pretendohet edhe për një rast tjetër sipas të cilit parashtruesit kanë marrë dhuratë nga babai i tyre në vitin 2000, një objekt me sipërfaqe 280 m<sup>2</sup>, në mënyrë që në vitin 2010, pa dijeninë e tyre, u është vendosur në hipotekë nga një banore e -----, e cila ka marrë kredi në marrëveshje me ish-drejtoreshën e bankës dhe në bashkëpunim me motrën e saj, punonjëse në MPB të Shkupit dhe një ish gjyqtar nga -----  
---

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në çështjen e hapur, KSHPK-ja i dërgoi parashtruesit kërkesë për plotësimin e kërkesës për të dhënë informacion të saktë për banesën e treguar, për të specifikuar personat konkretë që ishin të përfshirë në procedurën për konfiskim të banesës, si dhe të deklarojë veprimet e kryera nga përmbaruesit dhe t'i bashkëngjisë parashtruesit aktet e dorëzuara prej tyre. Ndaj kërkesës nuk është dorëzuar përgjigje nga ana e parashtruesit.

Duke marrë parasysh sa më sipër, KSHPK-ja vlerësoi se në rastin konkret nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për shkak të të dhënave dhe informacioneve të pamjaftueshme për rastin e denoncuar dhe parashtruesi nuk i është përgjigjur kërkesës së KSHPK-së për plotësimin e kërkesës., pas së cilës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E  
KORRUPSIONIT  
Nënkryetar  
Nuri Bajrami